




Lajmëtari informativ i Qytetit të Shkupit

SHKUPË

KORRIK 2016

Numër
falas

RRETHRROTULLIM I RI MES AUTOKOMANDËS DHE HEKURANËS



PASTAJ



RRETHRROTULLIM I RI MES AUTOKOMANDËS DHE HEKURANËS

MË PARË



Ekipet e Qytetit të Shkupit ndërtuan rrethrotullim të ri mes rrugëve 16. Makedonska brigada dhe Koce Metalec në lagjen Autokomandë, në komunën e Gazi Babës. Kjo zgjidhje e re komunikacioni kontribuoi në rritjen e sigurisë në trafik nga Autokomandë për në Hekuranë si dhe në rregullimin e hapësirës.

- Me këtë projekt, në vendin e kryqëzimit me rrugëve 16. Makedonska brigada dhe Koce Metalec u ndërtua rrethrotullim me diametër të brezit të gjelbër qendror prej 60 metra. Në rrethrotullim janë formuar 2 korsi trafiku me gjerësi të përgjithshme prej 9 metra. U bë edhe rikonstruksioni i rrugës automobilistike 16. Makedonska brigada,


në gjatësi prej 390 metra, si dhe një pjesë e rrugës Koce Metalec, në gjatësi prej 240 metra. Përgjatë rrethrotullimit dhe në rrugët hyrëse është ndërtuar trotuar i ri me gjerësi prej 3 metra dhe korsi për biçikleta me gjerësi prej 2,5 metra. Për pastrimin e ujërave atmosferike nga rrethrotullimi i ri është ndërtuar kanalizim atmosferik me Φ 600 milimetra dhe Φ 400 milimetra, në gjatësi prej gjithsej 634 metra. Gjatë punimeve ndërtimore është bërë mbrojtja e gypave të gazsjellësit si dhe është vendosur rrjet i ri ujësjellësi me Φ 200 milimetra, në gjatësi prej 52 metra – theksoi kryetari i qytetit Koce Trajanovski.

Në ndërtimin e rrethrotullimit të ri mes rrugëve 16. Makedonska brigada dhe Koce Metalec punuan ekipet e kompanisë ndërtimore "Bauer BG", kurse Qyteti i Shkupit për punët ndërtimore investoi rreth 45 milion denarë.

Në rrethrotullimin e ri është vendosur edhe ndriçim rrugor, me 35 shtylla për ndriçim rrugor me lartësi prej 8 metra dhe 39 llamba me fuqi prej 250 vat. Për vendosjen e ndriçimit dhe dislokimin e instalimeve Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 4,3 milion denarë.

Pjesa qendrore e rrethrotullimit si dhe pjesët anësore janë rregulluar me sipërfaqe të gjelbër me sipërfaqe prej gjithsej 11.800 metra katror. Gjelbërimi është me sistem për ujitje me 34 spërkatëse, 22 hidrantë, 13 puseta dhe 4 puseta për sistemin pikë pas pike. Në shportën e rrethrotullimit dhe përgjatë saj janë mbjellë rreth 10.000 lule. Në rregullimin e gjelbërimit punuan ekipet e NP "Parqe dhe gjelbërim", kurse Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 4,3 milion denarë.

Me këtë, vlera e përgjithshme e projektit për ndërtimin dhe rregullimin e rrethrotullimit mes rrugëve 16. Makedonska brigada dhe Koce Metalec është rreth 53,6 milion denarë.



ZGJERIMI I BULEVARDIT “PARTIZANSKI ODREDI” NË GJORÇE PETROV PARA PËRFUNDIMIT

Punët ndërtimore për zgjerimin e bulevardit “Partizanski odredi” nga rrethrotullimi tek Porta Vlae deri tek rrethrotullimi tek kisha „Shën Pjetri dhe Pali” në Gjorçe Petrov hyjnë në fazën përfundimtare. Në terren tashmë është vendosur plotësisht kanalizimi atmosferik, kurse rruga automobilistike është zgjeruar përgjatë gjithë gjatësisë së planifikuar prej 500 metrash. Në vijim janë punët përgatitore për asfaltimin e rrugës automobilistike.

Sipas projektit, nga rrethrotullimi tek Porta Vlae deri në rrethrotullimin tek kisha „Shën Pjetri dhe Pali” në Gjorçe Petrov, po kryhet zgjerimi i rrugës automobilistike ekzistuese, gjë me të cilën do të formohet një bulevard me 6 korsi rrugore, nga 3 në të dy drejtimet. Bulevardi do të ketë gjelbërim të mesëm me gjerësi 5 metra.

Bulevardi i ri i zgjeruar nga të dyja anët do të ketë korsi për këmbësorë dhe për biçikleta. Do të vendoset edhe ndriçim i ri rrugor.



Për punët ndërtimore të kësaj pjese Qyteti i Shkupit do të ndajë rreth 37,5 milion denarë, kurse në terren punojnë ndërtimtarët e kompanisë „Pelagonija” nga Gostivari. Ndriçimi rrugor do të vendoset nga firma „Eltra”, gjë për të cilën Qyteti

i Shkupit do të investojë rreth 2 milion denarë. Me këtë, investimi i përgjithshëm në këtë projekt për zgjerimin dhe rikonstrukcionin e bulevardit “Partizanski odredi” është rreth 40 milion denarë.

PO ZGJATOHET BULEVARDI “SERBIA”



Bulevardi “Serbia” i cili po zgjerohet deri në rrugën “Hristo Tatarçev” do të mundësojë përmirësimin e komunikacionit rrugor ndërmjet komunave Aerodrom, Sopishtë dhe Gazi Baba. Në terren deri tani ka përfunduar kanalizimi atmosferik me gjatësi 450 metra,

kurse në vijim janë punët ndërtimore për zgjerimin e rrugës automobilistike.

Me këtë projekt kryhet zgjerimi dhe rikonstrukcioni i bulevardit “Serbia” nga rrethrotullimi tek “Cementarnica” deri në rrugën “Hristo Tatarçev”, kurse në fund të këtij bulevardi do të ndërtohet rrethrotullim i ri ndërmjet bulevardit “Serbia”, rrugës “Hristo Tatarçev” dhe rrugës “Hristo Tatarçev” dega 2. Bulevardi “Serbia” po zgjerohet në gjatësi 868 metra, dhe do të formohen 4 korsi rrugore. Përgjatë trasesë së re nga ana e djathtë do të ketë gjelbërim anësor me gjerësi 1,5 metra dhe korsi këmbësorësh dhe biçikletash me gjerësi 3 metra, kurse nga ana e majtë do të ketë korsi këmbësorësh dhe biçikletash me gjerësi të ndryshme. Bulevardi i ri do të ketë gjelbërim të mesëm me gjerësi 2 metra. Në fund të bulevardit të ri do të ketë rrethrotullim me diametër 36 metra, dy korsi rrugore dhe korsi për këmbësorë. Do të kryhet edhe rikonstrukcioni dhe zgjerimi i rrugëve “Hristo Tatarçev” dhe “Hristo Tatarçev” dega 2, në pjesët që hyjnë në rrethrotullim. Për largimin e ujërave atmosferik të bulevardit “Serbia” do të ndërtohet kanalizim i ri atmosferik – thotë kryetari Koce Trajanovski.

Bulevardi “Serbia” në këtë pjesë të rrethrotullimit do të ketë ndriçim të ri rrugor. Shuma e përgjithshme e këtij projekti është 98 milion denarë. Realizues i punëve ndërtimore është „Bauer BG”.

SË SHPEJTI KATËR KORSI PËR PJESËN E DYTË TË BULEVARDIT “TRETA MAKEDONSKA BRIGADA”...

Pjesa e dytë e bulevardit “Treta makedonska brigada”, nga kryqëzimi me rrugën “Vasko Karangelevski” deri në rrugën “Nikolla Karev” së shpejti do të ketë 4 korsi rrugore gjë me të cilën do të lehtësohet në mënyrë të ndjeshme zhvillimi i komunikacionit rrugor në këtë pjesë të qytetit.

Në pjesën me gjatësi 1.400 metra, bulevardi “Treta makedonska brigada” do të zgjerohet, do të formohet brez i gjelbër me gjerësi 1,5 metra, korsi për biçikleta dhe këmbësorë. Do të ndërtohet edhe zhardinierë ndarëse me gjerësi 5 metra. Në terren po vendoset edhe kanalizim i ri atmosferik me gjatësi të përgjithshme 1.250 metra dhe tuba polipropileni me profil 500 dhe 800 milimetra, si dhe ndriçim i ri rrugor.

Për punët ndërtimore, për dislokimin e instalimeve nëntokësore dhe për ndriçimin e kësaj pjese të re të zgjeruar Qyteti i Shkupit do të shpenzojë rreth 104 milion denarë. Në



zgjerimin dhe rikonstruksionin e bulevardit “Treta makedonska brigada”, faza e dytë, nga kryqëzimi me rrugën “Vasko Karangelevski”

deri në rrugën “Nikolla Karev” punojnë ekipet e kompanisë së ndërtimit “Eskavatori D00”.

...DHE PËR PJESËN E TRETË TË BULEVARDIT “BORIS TRAJKOVSKI”

Ekipet e Qytetit të Shkupit këto ditë punojnë në zgjerimin dhe rikonstruksionin e pjesës së tretë të bulevardit “Boris Trajkovski”, nga fabrika e mëparshme „Staklarnica” deri në hyrjen e lagjes Pintija, me gjatësi 2.200 metra.

- Bulevardi “Boris Trajkovski” edhe në këtë pjesë do jetë një rrugë automobilistike moderne me 4 korsi rrugore, korsi për këmbësorë nga të dyja anët, si dhe korsi për biçikleta nga ana e majtë. Punët ndërtimore në rrugën “Boris Trajkovski” do të shfrytëzohen për të ndërtuar kanalizim të ri atmosferik përgjatë rrugës automobilistike, me tri degë, me gjatësi të përgjithshme 2.284 metra dhe profil të ndryshëm nga Ø 300 deri në Ø 1.000 milimetra. Në këtë pjesë do të vendoset edhe ndriçim i ri rrugor me 121 shtylla për ndriçim rrugor. Me realizimin edhe të kësaj faze të tretë të këtij projekti, qytetarët do të kenë rrugë automobilistike moderne me gjatësi të përgjithshme 6 kilometra nga Kisela Voda deri në Pintija dhe lagjet përreth – sqaron kryetari Koce Trajanovski.



Mjetet për realizimin e këtij projekti kapital janë siguruar nëpërmjet kredisë bankare vendase të Qytetit të Shkupit, i cili nënshkroi Kontratë për nën-kredi me Ministrinë e financave, në suazat e mjeteve të siguruara me Projektin për përmirësimin e shërbimeve komunale të financuar me

kredi nga Banka ndërkombëtare për rinovim dhe zhvillim – Banka Botërore. Shuma e përgjithshme e realizimit të këtij projekti është rreth 3,7 milion euro. Realizues i punëve ndërtimore është konzorciumi i përbërë nga kompanitë „DG Beton AD”, „Bauer BG” dhe „Ponstroj inzhenering EAD”.

PO ZGJEROHET BULEVARDI “ASNOM” ...

Punët ndërtimore në fazën e parë të projektit për zgjerimin dhe rikonstruksionin e bulevardit “ASNOM” janë në vijim. Me këtë projekt do të zgjerohen dhe rikonstruktohen 430 metra nga bulevardi “ASNOM”, nga objekti i Federatës së futbollit të Maqedonisë (Shtëpia e futbollit) deri te shtëpitë e para në rrugën “Todor Çangov”, në Lisiçe.

Me zgjerimin, bulevardi “ASNOM” në këtë pjesë do ketë 4 korsi rrugore, nga dy korsi në çdo drejtim, me gjerësi 3,5 metra. Do të realizohet edhe gjelbërimi i mesëm me gjerësi të ndryshueshme nga 2 deri në 5 metra, si dhe trotuare, korsi për biçikleta dhe gjelbërim ndarës.

Në terren tashmë është vendosur kanalizim i ri atmosferik me gjatësi 221 metra dhe me profil të tubave 500 milimetra.

Për ndriçimin e rrugës automobilistike të zgjeruar



do të vendosen 28 shtylla për ndriçim rrugor. Në zgjerimin dhe rikonstruksionin e bulevardit “ASNOM”, nga objekti i Federatës së futbollit të Maqedonisë deri në shtëpitë e para në Lisiçe do të punojnë ndërtimtarët e kompanisë DG „Beton” SHA Shkup. Në këtë punë ndërtimore të rëndësishme Qyteti i Shkupit do të investojë rreth 31,8 milion denarë.

... DHE RRUGA “TODOR ALEKSANDROV”, NË VODNO

Me projektin për zgjerimin dhe rikonstruksionin e rrugës “Todor Aleksandrov” kjo rrugë automobilistike me frekuencë të lartë do të zgjerohet nga kryqëzimi me bulevardin “Nënë Tereza” dhe rrugën “Belgradska”, tek SHF „Koço Racin”, deri në degën e kësaj rruge që të çon drejt Panoramës, me gjatësi rreth 600 metra. Me këtë, do të mundësohet zhvillimi i lagjeve që gjenden në rrëzë të Vodnos, si dhe lëvizja e pandërprerë e vizitorëve gjithnjë e më të shumtë në numër drejt përmbajtjeve për rekreacion në Vodno.



- Me realizimin e projektit për zgjerim dhe rikonstruksion, rruga “Todor Aleksandrov” do të ketë 4 korsi rrugore, nga 2 korsi në çdo drejtim, me gjerësi 3 metra. Nga të dyja anët e rrugës automobilistike do të formohen trotuare me gjerësi 2 metra. Në terren do të kryhet edhe rikonstruksioni i rrugës automobilistike ekzistuese, asfalti i vjetër dhe i dëmtuar do të gërvishet, do të rinovohet shtresa bartëse dhe do të shtrohet asfalt i ri. Punët ndërtimore në rrugën “Todor Aleksandrov” do të shfrytëzohen për të rikonstruktuar edhe një pjesë të kanalizimit atmosferik në këtë rrugë automobilistike, gjatë së cilës në gjatësi prej 500 metrash do të vendosen tuba me profil 400 milimetra. Do të rikonstruktohet edhe një pjesë e rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza, ku në gjatësi prej 300 metrash do të vendosen tuba me profil 250 dhe 300 milimetra. Do të rikonstruktohet edhe një pjesë e rrjetit të ujës jellës në këtë rrugë, gjatë së cilës në gjatësi prej 200 metrash, do të vendosen tuba me profil 250 milimetra – thotë kryetari Koce Trajanovski.

Pas përfundimit të rikonstruksionit, në rrugën “Todor Aleksandrov” do të vendoset ndriçim i ri me 33 shtylla për ndriçim rrugor.

- Në zgjerimin dhe rikonstruksionin e rrugës “Todor Aleksandrov” do të punojnë ekipet e kompanisë së ndërtimit „Zhikol” nga Strumica. Qyteti i Shkupit në këtë projekt voluminoz do të investojë rreth 39 milion denarë – sqaron Trajanovski.

PO DEPËRTOHET BULEVARDI "HRISTIJAN TODOROVSKI KARPOSH NË BUTEL



Ndërtimi i bulevardit "Hristijan Todorovski Karposh", nga kryqëzimi me bulevardin "Bosna i Hercegovina" deri në rrugën "Natanail Kučevishki" (faza e parë) është në vijim. Në këtë fazë do të depërtohen 1.000 metra të bulevardit "Hristijan Todorovski Karposh".

Bulevardi i ri do të ketë gjerësi 40 metra dhe 6 korsi rrugore, korsi për biçikleta dhe këmbësorë nga të dyja anët e bulevardit dhe gjelbërim të mesëm.

Në pjesën e re të bulevardit "Hristijan Todorovski Karposh" do të vendoset rrjet i ri ujësjellësi, kanalizim i ri atmosferik me profil ϕ 600, dhe do të ndërtohet edhe kanalizim i ri i ujërave të zeza. Në bulevard do të vendoset ndriçim i ri rrugor.

Për punët ndërtimore të fazës së parë të projektit kapital për depërtimin e bulevardit "Hristijan Todorovski Karposh", Qyteti i Shkupit do të ndajë rreth 160 milion denarë.

DO TË ZGJEROHET BULEVARDI "HRISTIJAN TODOROVSKI KARPOSH" NË ÇAIR

Ekipet e Qytetit të Shkupit punojnë në zgjerimin dhe rikonstruksionin e bulevardit "Hristijan Todorovski Karposh", nga bulevardi "Xhon Kenedi" deri në rrugën "Rokomija" në Çair, si dhe në vendosjen e ndriçimit rrugor nga "Xhon Kenedi" deri në rrugën "Ferid Bajram".

- Qyteti i Shkupit vazhdon me ofensivën pranverore ndërtimore. Rruga automobilistike ekzistuese në bulevardin "Hristijan Todorovski Karposh" në këtë pjesë do të zgjerohet dhe do të ketë 4 korsi, nga dy korsi në çdo drejtim, me gjatësi 670 metra. Nga ana e majtë e bulevardit, shikuar nga qendra e qytetit drejt Çairit, do të ndërtohet trotuar me gjerësi 4 metra. Nga ana e djathtë e rrugës automobilistike do të formohet gjelbërim mbrojtës me gjerësi të ndryshme, korsi për biçikleta me gjerësi 2,25 metra dhe korsi për këmbësorë me gjerësi 2 metra. Në bulevardin "Hristijan Todorovski Karposh" do të vendoset kanalizim i ri atmosferik me gjatësi 280 metra dhe me profil të tubave prej 400 milimetrash. Planifikohet të ndërtohet edhe rrjet i ri kanalizimi me gjatësi

255 metra, si dhe rrjet i ri ujësjellësi me gjatësi 850 metra – thotë kryetari Koce Trajanovski.

Përgjatë bulevardit "Hristijan Todorovski Karposh" do të vendoset ndriçim i ri rrugor, nga bulevardi "Xhon Kenedi" deri në rrugën "Ferid Bajram", me gjatësi 940 metra. Në këtë drejtim do të vendosen 63 shtylla për ndriçim rrugor.

Për realizimin e projektit për zgjerimin

dhe rikonstruksionin e bulevardit "Hristijan Todorovski Karposh", nga bulevardi "Xhon Kenedi" deri në rrugën "Rokomija" dhe për vendosjen e ndriçimit rrugor nga bulevardi "Xhon Kenedi" deri në rrugën "Ferid Bajram", Qyteti i Shkupit do të investojë rreth 43 milion denarë. Në terren punojnë ekipet e kompanisë „Bauer BG”.



RRUGA “GJORÇE PETROV” DO TË SHTROHET ME ASFALT TË RI



Rruga “Gjorçe Petrov”, nga rrethrotullimi tek SP „Planet” deri në godinën e komunës, në periudhën e ardhshme do të shtrohet me asfalt të ri.

Në pjesën me gjatësi 1.245 metra asfalti ekzistues i dëmtuar do të gërvishtet, do të riparohet

shtresa bartëse dhe do të shtrohet shtresë e re asfalti Split Mastiks me trashësi 5 centimetra. Në vendet ku është e nevojshme do të zëvendësohen bordurat e dëmtuara, dhe do të kryhet riparimi i trotuareve të cilat do të shtrohen me asfalt, në një sipërfaqe prej 1.000 metra katrorë.

Për rikonstruksionin e rrugës automobilistike të rrugës “Gjorçe Petrov”, nga rrethrotullimi tek SP „Planet” deri në godinën e komunës, Qyteti i Shkupit do të investojë rreth 18,6 milion denarë. Në terren punojnë ndërtimtarët e kompanisë „Pelagonija” SHA Gostivar.

U RIPARUAN RRUGËT NË KOMUNAT BUTEL DHE KISELA VODA



Ekipet e Qytetit të Shkupit dhe të NP „Rrugë dhe rrugica” këtë pranverë riparuan një numër të madh rrugësh në komunat Butel dhe Kisela Voda. Në këtë aksion u rinovua rruga automobilistike në rrugët “Mrezhička” me gjatësi 200 metra; “Kole Kaninski” me gjatësi 160 metra; “Ho Shi Min”, “Zufir Musiq” dhe “Ljuba Petroviq”, në komunën Butel.

Në komunën Kisela Voda, nga ana tjetër, u riparuan plotësisht rrugët 1 dhe 3 në lagjen Usje me gjatësi të përgjithshme 270 metra.

ASFALT PËR RRUGËT NË VARREZAT „BUTEL” DHE „KAMNIK”

Qyteti i Shkupit investoi rreth 3,5 milion denarë për asfaltimin e një numri të madh të rrugëve në varrezat „Butel” dhe „Kamnik”, me sipërfaqe të përgjithshme 3.000 metra katrorë. Në terren punojnë ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica”.

Nga viti 2012 deri tani Qyteti i Shkupit në varrezat e qytetit ka asfaltuar rrugë me sipërfaqe të përgjithshme rreth 12.000 metra katrorë.



PO RINOVOHET RRUGA AUTOMOBILISTIKE SARAJ



Punët ndërtimore për rinovimin e rrugës automobilistike Saraj, nga kisha „Shën Zlata Meglenska” deri në rrugën që të çon drejt fshatit Lubin, janë në vijim. Në fazën e parë të projektit për rikonstruksionin e rrugës automobilistike Saraj do të rinovohen 665 metra të kësaj rruge automobilistike të rëndësishme.

- Gjatë punëve ndërtimore të rrugës Saraj do të gërvihet shtresa e asfaltit ekzistues, do të rinovohet plotësisht shtresa bartëse dhe do të shtrohet asfalt i ri. Me projektin është parashikuar të rregullohen sërish pllakat e

begatonit në trotuar, si dhe nivelimi i pusetave dhe vendgrumbullimeve. Qyteti i Shkupit për këtë punë ndërtimore ndau rreth 5 milion denarë, kurse në terren punojnë ndërtimtarët e kompanisë „Pelagonija” SHA Gostivar. Dua të theksoj bashkëpunimin e mirë me komunën e Sarajit dhe të potencoj se Qyteti i Shkupit edhe në periudhën e ardhshme do të vazhdojë me realizimin e projekteve për përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve në Saraj – sqaroi kryetari Koce Trajanovski.

Gjatë punëve ndërtimore në rrugën Saraj komunikacioni rrugor do të zhvillohet

sipas një regjimi rrugor të përcaktuar paraprakisht, gjë për të cilën qytetarët do të informohen në kohë.

Në Qytetin e Shkupit po punohet edhe në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për fazën e dytë dhe të tretë të projektit për rikonstruksionin e rrugës Saraj, me realizimin e së cilës kjo rrugë automobilistike e rëndësishme do të rikonstruktohet dhe do të marrë një pamje të re në drejtimin nga kisha „Shën Zlata Meglenska” deri në kryqëzimin me rrugën lokale - lokaliteti Matka dhe kryqëzimi për Tetovë.

RIKONSTRUKSION I RRUGËS NUMËR 5 NË SARAJ



Ekipet e Qytetit të Shkupit dhe NP „Rrugë dhe rugica” këto ditë bënë rikonstruksionin e rrugës automobilistike numër 5, në Saraj. Janë asfaltuar gjithsej 600 metra të kësaj rruge me çka u përmirësua siguria për të gjithë pjesëmarrësit në trafik.

Për rikonstruksionin e rrugës numër 5 në Saraj Qyteti i Shkupit ndau rreth 3 milion denarë.



PO NDËRTOHET SISTEM I RI UJËSJELLËSI PËR SHUTO ORIZARE



Punët ndërtimore në sistemin e ri të ujësjellësit për komunën Shuto Orizare hynë në fazën përfundimtare. Stacioni i pompimit tek fabrika e mëparshme SHA „TIPO” në bulevardin “Sllovenia” është ndërtuar plotësisht, janë montuar edhe pompat për ujë dhe stacioni është lidhur me rrjetin e ujësjellësit. Është ndërtuar edhe rezervuari në rrugën “Guadalajara” dhe po punohet në montimin e instalimit të ujësjellësit.

- Me ndërtimin e këtij sistemi për furnizimin me ujë do të zgjidhen problemet shumëvjeçare me furnizimin me ujë të pijshëm në lagjet Shuto Orizare dhe në një pjesë të Shkupit verior. Për sistemin e ri të ujësjellësit po ndërtohet rezervuar me kapacitet 4.350 metra kub në afërsi të rezervuarëve ekzistues të NP „Ujësjellës dhe kanalizim” në rrugën “Guadalajara”; stacioni i pompimit tek fabrika e mëparshme SHA „TIPO” në bulevardin “Sllovenia” dhe tubacion me gjatësi 2,3 kilometra dhe profil 500 milimetra i cili kalon nga stacioni i pompimit, pastaj nëpër rrugët “Shuto Orizare”, “Vinička”, “Çe Gevara”, “Plačkovica” dhe “Butelski venec” – thotë kryetari Koce Trajanovski.

Vlera e përgjithshme e investimit është 182.367.800 denarë me TVSH të përfshirë. Në financimin e këtij projekti Qyteti i Shkupit do të marrë pjesë me 43,7 % të mjeteve, përkatësisht me 79,7 milion denarë; NP „Ujësjellës dhe kanalizim”, gjithashtu, me 43,7 %, përkatësisht 79,7 milion denarë, kurse Komuna Shuto Orizare do të marrë pjesë me 12,6 %, përkatësisht 22,9 milion denarë të mjeteve financiare të nevojshme.



PO NDËRTOHET KOLEKTORI I UJËRAVE TË ZEZA NË BULEVARDIN “VIDOE SMILEVSKI BATO”

Punët ndërtimore në kolektorin e ujërave të zeza përgjatë bulevardit “Vidoë Smilevski Bato” zhvillohen sipas dinamikës së parashikuar.

Sipas projektit, në terren po ndërtohet kolektor i ri i ujërave të zeza me gjatësi të përgjithshme 771 metra, nga fundi i bulevardit “Vidoë Smilevski Bato” deri në kryqëzimin me bulevardin “Serbia”. Në këtë drejtim tashmë janë vendosur tubat e kanalizimit prej propileni me

profil 800 milimetra, të cilat janë të lidhura me kolektorin ekzistues. Po formohet edhe korsi për biçikleta përgjatë bulevardit “Vidoë Smilevski Bato” dhe po bëhen përgatitje për asfaltim. Për realizimin e këtij projekti Qyteti i Shkupit do të ndajë rreth 27 milion denarë.

Me realizimin e këtij projekti do të zgjidhen problemet shumëvjeçare të banorëve të kësaj pjese të lagjes Aerodrom me rrjetin e kanalizimit.



UJËSJELLËS I RI PËR RRUGËN “GJORGJI KAPÇEV”



Me qëllim që të përmirësohet furnizimi me ujë të pijshëm i qytetarëve të Lisiçes së epërme ekipet e NP „Ujësjellës dhe kanalizim” po vendosin rrjet të ri ujësjellësi në rrugën “Gjorgji Kapçev”.

- Me këtë projekt po rikonstruhet rrjeti i ujësjellësit në rrugën “Gjorgji Kapçev”, si dhe 4 degë të saj, përkatësisht me këtë rikonstrukcion do të përfshihet rrjeti i ujësjellësit me gjatësi të përgjithshme 1.900 metra. Në terren po vendosen tuba polietileni me profile të ndryshme. Me realizimin e këtij projekti do të përmirësohet në mënyrë të ndjeshme furnizimi me ujë në këtë pjesë të vendbanimit Lisiçe e epërme, kurse dobi të drejtpërdrejtë nga rrjeti i ri ujësjellësit do të kenë 630 banorë. Për rikonstrukcionin e rrjetit të ujësjellësit në rrugën “Gjorgji Kapçev” dhe degëve të saj NP „Ujësjellës dhe kanalizim” do të investojë 21 milion denarë – thotë kryetari Koce Trajanovski.

Pas ndërtimit të ujësjellësit të ri Komuna Aerodrom do të rikonstruktojë rrugën automobilistike.

QSHAK „BORO PETRUSHEVSKI“ DO TË KETË SALLË TË RE FIZKULTURE

Nxënësit e QSHAK „Boro Petrushevski“ do të kenë mundësi të merren me sport në sallën e re të fizkulturës që do të ndërtohet në oborrin e shkollës.

- Me ndërtimin e sallës së re të fizkulturës për rreth 930 nxënës që ndjekin mësimin në QSHAK „Boro Petrushevski“ do të përmirësohen kushtet për mbajtjen e mësimin të edukatës fizike, si dhe për sport dhe rekreacion të nxënësve të kësaj shkolle të mesme – thotë kryetari Koce Trajanovski.

Salla e re e fizkulturës do të ketë kat përdhës me sipërfaqe 1.002 metra katrorë, si dhe një kat me sipërfaqe 405 metra katrorë. Objekti është me gjatësi 54,5 metra, gjerësi 19,9 metra dhe lartësi 8,6 metra. Objekti i ri do të ketë një sallë të madhe sportive, sallë ping-pongu, sallë të vogël gjimnastike, ambient për rekuizita,



tri gardëroba, tualete dhe ambiente për profesorët.

Në fazën e parë të projektit për ndërtimin e sallës së fizkulturës në QSHAK „Boro Petrushevski“ është parashikuar ndërtimi i objektit, përderisa rregullimi i brendshëm dhe pajimi do të kryhet në fazën

e dytë.

Për realizimin e fazës së parë të projektit për ndërtimin e sallës së fizkulturës për nevojat e QSHAK „Boro Petrushevski“, Qyteti i Shkupit do të ndajë 10.859.769 denarë, kurse punët ndërtimore do të realizohen nga KN „Granit“.

POLIGONI URBAN I BIÇIKLETAVE ATRAKSION I RI PËR FËMIJËT



Poligoni urban i biçikletave që u ndërtua muajin e kaluar në Parkun Maqedonia është një atraksion i vërtetë për fëmijët, të cilët kanë mundësi të ngasin biçikletat dhe të mësojnë rregullat dhe shenjat e komunikacionit rrugor.

- Ky poligon i biçikletave për fëmijët në Parkun Maqedonia është donacion i Stopanska Banka. Shfrytëzoj rastin t' i falënderoj për pjesëmarrjen në këtë projekt. Poligoni i biçikletave për fëmijë është me sipërfaqe 660 metra katrorë, me gjatësi korsie 270 metra dhe pajisje urbane: bamperë, rampë, parkim për biçikleta, lëkundës, rrëshqitëse, sipërfaqe të mbushur me rërë, stola për ndenje, tavolina pikniku dhe kosha për mbeturina. Korsia e biçikletave për fëmijë është me gjatësi 270 metra dhe gjerësi 120 centimetra, e cila nga të dyja anët ka trotuar me gjerësi 50 centimetra për mësuesit dhe ndihmësit e tyre. Bazat e korsisë së biçikletave janë të tre tipave: korsia më e gjatë është prej gome, bazë betoni me gjerësi 120 centimetra, me kalldrëme nga të dyja anët nga 50 centimetra, që simbolizojnë trotuarët; pjesa e dytë është kalldrëm, kurse e treta është prej druri, përkatësisht urë

druri. Në sipërfaqet e barit rreth parkingut për biçikleta dhe zonës për lëkundëse janë vendosur 12 stola për ndenje, 4 komplete me tavolina pikniku dhe stola, si dhe kosha për mbeturina. Në ndërtimin e këtij poligoni edukativ u shfrytëzuan materiale ekologjike. Vlera e këtij projekti është 1.234.000 denarë – theksoi kryetari Koce Trajanovski, në hapjen e poligonit.

Milica Çaparovska Jovanovska, drejtoresha e përgjithshme për aktivitetet bankar me pakicë nga Stopanska banka deklaroi se është një rast i rrallë që një hapësirë e tillë publike të pasurohet dhe transformohet në një kat për rekreacion, argëtim, dhe edukim të fëmijëve.

- Përhëndes besimin e treguar dhe përkrahjen nga Qyteti i Shkupit gjithë këto muaj dhe është kënaqësi e veçantë t'ia dorëzojmë këtë poligon Qytetit të Shkupit dhe gjithë qytetarëve të Shkupit që do ta përdorin atë – tha Jovanovska.



PO RIPAROHET SIPËRFAQJA E JASHTME E URËS „GOCE DELÇEV“



Ekipet e Qytetit të Shkupit këto ditë riparojnë sipërfaqen e jashtme prej betoni të urës „Goce Delçev“.

- Gjatë punëve ndërtimore mënjanohej shtresa e dëmtuar e betonit në ato vende ku është e nevojshme, shtrohet shtresë mbrojtëse anti-korrozive e armaturës dhe kryhet riparimi dhe mbrojtja e sipërfaqes. Në riparimin e anës së jashtme të „Goce Delçev“ punojnë ndërtimtarët e kompanisë „Sintek inzhenering SHPKTHPV Shkup“, kurse Qyteti i Shkupit për këtë punë do të ndajë rreth 11 milion denarë – thotë kryetari Koce Trajanovski.

Projekti për riparimin e sipërfaqes së jashtme prej betoni të urës „Goce Delçev“ është në bazë të ekspertizës së përgatitur nga kompania e huaj „Fresine“, në të cilën rekomandohet riparimi i sipërfaqes së jashtme të urës e cila është dëmtuar nga kushtet atmosferike.

- Firma „Fresine“, e cila është lider në përgatitjen e konstruksioneve të urave, në vitin 2001 realizoi riparimin e elementeve konstruktivë të urës „Goce Delçev“, por gjatë kësaj pune ndërtimore nuk u riparua sipërfaqja e jashtme e urës – shtoi kryetari Trajanovski.

Gjatë punëve ndërtimore komunikacioni rrugor në urë do të zhvillohet pa ndërprerje dhe pa kufizime.



„SHKUPI“

LAJMËTARI INFORMATIV I

QYTETIT TË SHKUPIT

Numri i parë i lajmëtarit informativ

„Shkupi“ u botua më:

10 dhjetor 2008

Redakton

Seksioni për marrëdhënie me publikun
i Qytetit të Shkupit

www.skopje.gov.mk

Përkthyes dhe lektor

Vladimir Bogdanovski

BOTON QYTETI I SHKUPIT

Bulevardi Ilinden 82

Telefon

02 3297 255

e-mail adresa

graggani@skopje.gov.mk

Dizajni/Botoi:

Pecatnica „Serafimovski“
Skopje

U ndërtuan korsi për biçikleta në Rrugën 1

LËVIZJE E PANDËRPRERË ME BIÇIKLETË NGA GAZI BABA NËPËRMJET QENDRËS DERI NË KARPOSH

Nga kjo pranverë çiklistët mund të lëvizin në mënyrë të pandërprerë nëpër korsitë e reja dhe të rinovuara të biçikletave dhe këmbësorëve që janë pjesë e Rrugës 1, e cila lidh Gazi Babën nëpërmjet qendrës së qytetit me Karposhin. Korsitë e biçikletave të Rrugës 1 të projektit „SHKUPI QYTETI I BIÇIKLETAVE 2017” u promovuan më 21 mars në paradën e biçikletave që u mbajt për gjatë bulevardit “Ilinden”, e cila udhëhiqej nga kryetari Koce Trajanovski.

- Pikërisht në Ditën e pranverës promovojmë korsitë e biçikletave të reja dhe të rinovuara të Rrugës 1, të projektit të ndërlkuar „SHKUPI QYTETI I BIÇIKLETAVE 2017”, me të cilin do të përmirësojmë infrastrukturën e çiklizmit në Shkup dhe do të rrisim sigurinë në komunikacionin e biçikletave. Korsitë e biçikletave nga Rruga 1 mundësuan lidhjen e Gazi Babës, nëpërmjet qendrës së qytetit me Karposhin. Si pjesë të rrugës, ndërtuam dhe rikonstruam korsi për biçikleta me gjatësi të përgjithshme 7.600 metra, si vijon: në bulevardin “Aleksandar Makedonski”, nga kryqëzimi tek hoteli „Kontinental”, deri te kryqëzimi Estekada, nga të dyja anët; në rrugën “Belasica”, nga bulevardi “Goce Delçev” deri te kryqëzimi tek hoteli „Kontinental”, nga të dyja anët; në bulevardin “Goce Delçev”, nga bulevardi “Krste Misirkov” deri në rrugën “Belasica”, nga të dyja anët; në bulevardin



“Ilinden”, para godinës së Qeverisë dhe në drejtimin nga kryqëzimi me bulevardin “Sveti Kliment Ohridski” deri në shatërvanin „Lotosov cvet”, nga të dyja anët dhe në bulevardin “Ilinden”, në drejtimin nga Shtëpia e gjendjes civile deri në kryqëzimin me rrugën “Ljubjanska”, nga njëra anë. Për ndërtimin dhe rikonstrukcionin e korsive të biçikletave të Rrugës 1 dhe të korsive të këmbësorëve përgjatë tyre Qyteti i Shkupit investoi 48 milion denarë. Punët ndërtimore

i realizuan ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica” – thotë kryetari Trajanovski.

Trajanovski shton se Qyteti i Shkupit ka një bashkëpunim të shkëlqyer me grupin joformal „Në biçikletë” të cilët për këtë projekt ndihmuan me sugjerime dhe vërejtje.

- Qëllimi ynë është krijimi kushteve për çiklizëm në Shkup dhe nxitja e qytetarëve që në një numër sa më të madh të përdorin biçikletën si mjet transporti – thotë kryetari Koce Trajanovski.



Në bulevardin Aleksandar Makedonski



Në bulevardin Ilinden

Projekti „SHKUPI QYTETI I BIÇIKLETAVE 2017“ – Rruga 2

PO FORMOHEN KORSITË E BIÇIKLETAVE NË AERODROM

Korsia e biçikletave nëpër anën e djathtë të bulevardit “Jane Sandanski”, në drejtimin nga bulevardi “Serbia” deri në Stacionin hekurudhor është rikonstruktuar tashmë dhe asfaltuar, kurse në periudhën e ardhshme ekipet e Qytetit të Shkupit do të punojnë në ndërtimin e korsisë së biçikletave nga ana e majtë e këtij bulevardi, si dhe përgjatë bulevardit “Partizanski odredi”, nga objekti “Tifani” drejt Gjorçe Petrov, nga të dyja anët. Këto korsi biçikletash janë pjesë e rrugës së dytë të projektit kapital për përmirësimin e infrastrukturës së çiklizmit në Shkup – „SHKUPI QYTETI I BIÇIKLETAVE 2017“.

Rruga 2 e këtij projekti është me gjatësi të përgjithshme 11 kilometra dhe do të lidhë komunën Aerodrom, nëpërmjet komunës Qendër dhe Karposh, deri në komunën Gjorçe Petrov. Ajo përfshin bulevardet “Fevruarski Pohod” “Vidoe Smilevski – Bato” “Jane Sandanski”, “Kuzman Josifovski Pitu”, “Kej 13 Noemvri”, sheshin “Maqedonia”, bulevardin VMRO dhe bulevardin “Partizanski odredi” deri në porta Vlae.

- Me këtë projekt do të formohen korsi biçikletash me cilësi të lartë, të shënuara me sinjalizim horizontal dhe vertikal të standardizuar, të qartë dhe të dukshëm dhe do të shtrohen me asfalt. Hyrjet në kryqëzime do të realizohen me rampa, përdorisa përgjatë korsive do të vendosen shtyllëza mbrojtëse. Gjithashtu, do të dislokohen të gjitha pengesat në korsitë e biçikletave siç janë bilbordet, kandelabrët, kontejnerët dhe shenjat rrugore. Me realizimin e këtij projekti do të mundësohet që banorët e Shkupit të shfrytëzojnë në mënyrë të pandërprerë biçikletën si mjet rekreativ dhe transporti, gjë me të cilën do të shkarkohet komunikacioni rrugor dhe do të ndikohet pozitivisht mbi ambientin jetësor – tha kryetari Koce Trajanovski.

Në terren punojnë ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica“.



NP „Higjiena komunale“

AUTOMJETE ELEKTRIKE PËR PASTRIMIN E SHESHEVE TË QYTETIT

Sheshet e qytetit dhe zonat e këmbësorëve nga fillimi i vitit po pastrohen me automjete elektrike.

- NP „Higjiena komunale“ është një ndër ndërmarrjet e para publike të qytetit që blenë automjete elektrike, që do të shfrytëzohen për pastrimin, larjen dhe lustrimin e pllakave të mermerit në sheshin „Maqedonia“, si dhe për pastrimin e shesheve të tjera dhe zonave të këmbësorëve në territorin e qendrës së qytetit. NP „Higjiena komunale“ bleu dy automjete elektrike – fsheza „Eureka“, një automjet – fshezë elektrike me fuqi motorike 5-6 kw dhe një automjet special komunal për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve komunale nga enë me kapacitet 120 litra – mbledhës mbetjesh, për të cilat u ndanë rreth 13,5 milion denarë. Paraprakisht edhe NP „Parkingu i qytetit“ bleu 7 elektromobila me dizajn retro, 5 elektrotrotinetë, 10 elektro biçikleta dhe pesë elektromobila. Qyteti i Shkupit bleu një automjet elektrik, 5 elektro skuterë dhe 5 elektro biçikleta që shfrytëzohen nga të punësuarit në administratën e qytetit. Dua të theksoj se të gjitha ndërmarrjet publike në buxhetet e tyre për vitin 2016 kanë planifikuar mjete për blerjen e automjeteve elektrike që do të shfrytëzohen nga të punësuarit e tyre – theksoi kryetari Koce Trajanovski, në promovimin e automjeteve të reja elektrike.

Drejtori i NP „Higjiena komunale“, Rakip Doçi, theksoi se këto automjete janë të lehta për përdorim, nuk krijojnë zhurmë dhe nuk e ndotin ajrin, që është shumë e rëndësishme sepse përdoren në ato pjesë të qytetit ku ka frekuencë të madhe këmbësorësh.

NP „Higjiena komunale“ bleu edhe tre elektromopedë – dy nga 2,5 kw dhe një nga 1,2 kw, që shfrytëzohen nga të punësuarit në këtë ndërmarrje publike.



U VENDOSËN 1.200 TABELA ME NUMRAT E SHTËPIVE NË VIZBEG

Ekipet e Qytetit të Shkupit në koordinim me bashkësinë vendore vendosën 1.200 tabela me numrat e shtëpive në vendbanimin Vizbeg, përkatësisht në rrugën 1, rrugën 2, rrugën 3, rrugën 4 dhe në rrugën 5.

Nevojën për ndërrimin dhe vendosjen e tabelave të reja e përcakton Sektori për punë komunale, mbi bazën e të dhënave paraprake të përcaktuara dhe azhuruara. Ky aktivitet zbatohet në përputhje me vendimin e Këshillit të Qytetit të Shkupit, që e solli

në seancën e 58-të, të mbajtur më 22 dhjetor 2015, për blerjen dhe vendosjen e tabelave me numrat e shtëpive.

Me këtë vendim përcaktohet obligimi i Qytetit të Shkupit për kryerjen e zëvendësimit të tabelave të zhdukura ose të dëmtuara me numrat e shtëpive, të vendosë tabela me numra në objektet në të cilat është kryer numërtimi i sërishëm i numrave, si dhe në raste të tjera të përcaktuara me ligj, në territorin e Qytetit të Shkupit. Shpenzimet për furnizimin dhe vendosjen e tabelave i mbuloi Qyteti i Shkupit.

U BLE AUTOMJET ELEKTRIK PËR ADMINISTRATËN E QYTETIT

Qyteti i Shkupit është qeverisja e parë vendore në Republikën e Maqedonisë që ka blerë automobil elektrik (elektromobil) për nevojat e administratës së qytetit. Automjeti i ri elektrik është i markës Nissan Leaf.

- Me blerjen e këtij automobili elektrik Qyteti i Shkupit është qeverisja e parë vendore në Republikën e Maqedonisë që ka blerë një automjet të tillë. Në këtë mënyrë vërtetojmë edhe këtë herë përpjekjet tona për elektromobilitet në Shkup, me zbatimin e teknologjive të reja, lëvizjes me emetim zero të gazrave nxjerrës të dëmshëm, ambient jetësor më të pastër dhe më të shëndetshëm dhe zvogëlim të shpenzimeve për mirëmbajtje. Ky automobil do të ketë 5 dyer, me drejtues



elektrik servo, me fuqi motorike 80 kilovatë dhe bateri 24 kwh. Me një lidhje të zakonshme automjeti mbushet rreth 10 orë, kurse me lidhje

të veçantë – për rreth 4 orë. Mbushja e plotë e baterisë, në rrymë elektrike të lirë, kushton 67 denarë, me të cilën automobili kalon 190 kilometra. Ajo që është më e rëndësishme është fakti se emetimi i dyoksidit të karbonit është 0 për qind, gjë me të cilën kontribuojmë në mënyrë direkte për ambient jetësor më të pastër dhe më të shëndetshëm – thotë kryetari Koce Trajanovski.

Për blerjen e këtij automobili Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 1,8 milion denarë. Automjeti është blerë nga firma TD „Ka-dis” SHPK Shkup.



LOKACION AUTOMATIK I AUTOMJETEVE TË TRANSPORTIT PUBLIK TË QYTETIT

Njoftimi në kohë i udhëtarëve për kohën e arritjes së autobusëve urbanë në stacion dhe ndjekja e gjendjes në komunikacionin rrugor në kohë reale për shkak të zvogëlimit të kaosit në komunikacion janë ndër përfitimet kryesore të Sistemit për lokacionin automatik të automjeteve të transportit publik urban gjë e cila në autobusët e NQP-së funksionon tashmë gjashtë muaj.

- Me vendosjen e këtij sistemi modern për lokacion automatik të automjeteve dhe pagim elektronik të biletave Shkupi dhe qytetarët e tij do të kenë transport publik më të shpejtë dhe më cilësor. Për realizimin e këtij projekti Qyteti i Shkupit dhe Ndërmarrja e transportit publik ndanë rreth 3 milion euro dhe presim me këtë të zvogëlojmë shpenzimin e karburantit dhe të rrisim kualitetin e transportit që do të kontribuojë në rritjen e numrit të udhëtarëve në autobusë. Ashtu siç paralajmëruam me vendosjen e kartave elektronike në autobusët e NQP-së do të ketë informacion të saktë për numrin e udhëtarëve në linja të caktuara dhe nëse ka nevojë do të ndërhyjmë që t'u mundësojmë qytetarëve transport urban më të shpejtë dhe më cilësor, përkatësisht transport të rregullt, të sigurtë dhe të saktë – thotë kryetari Koce Trajanovski.

Sistemi për lokacionin automatik dhe për pagimin elektronik duhet të instalohet në 500 autobusë të transportit publik urban, përkatësisht tashmë është instaluar në 384 autobusë të NQP-së, dhe së shpejti do të instalohet edhe në 116 autobusë të transportuesve



privatë.

Ky sistem përbën një mjet të fuqishëm për ndjekjen e autobusëve në kohë reale, respektimin e orareve të caktuara të udhëtimit, si dhe mundësimin e korrigjimeve dhe zvogëlimin e kohës së pritjes në përputhje me gjendjen reale në komunikacionin rrugor në rrugët e qytetit, si dhe pamjen reale për numrin e udhëtarëve të transportuar sipas kategorive. NQP-së ky sistem i mundëson të dimensionojë linjat e autobusëve në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe të gjenerojë automatikisht itinerarin e udhëtimit, dhe e gjitha kjo në një masë të madhe do të kontribuojë në rritjen e kualitetit të shërbimeve të transportit.

CERTIFIKATA PËR TRAJNIMIN E KRYER PËR 30 ZJARRFIKËS

Certifikatat për trajnimin e kryer me sukses „Përgjigje për situata urgjente mjekësore” më 19 maj iu ndanë 30 të punësuarve të rinj në Brigadën për mbrojtjen kundër zjarreve të Qytetit të Shkupit. Në këtë trajnim zjarrfikësit fituan dijeni për dhënien e ndihmës mjekësore në situata urgjente, siç janë: identifikimi dhe reagimi adekuat gjatë traumave, reanimacioni i zemrës dhe mushkërive, imobilizimi i pacientëve të lënduar dhe transporti adekuat, triaza gjatë aksidenteve katastrofike me numër të madh të lënduarish, reagim gjatë afiksimit, teknika të kontrollit të



pulsit dhe hapja e rrugëve të frymëmarrjes, lidhja e plagëve, puna ekipore në rast aksidentesh dhe lëndimesh etj.

Trajnimi „Përgjigje për situata urgjente mjekësore” u realizua nga organizata joqeveritare „Link Akros”.

DITA E ZJARRFIKËSVE 2016

Qyteti i Shkupit tradicionalisht kremtoi 20 Majin – Dita e zjarrfikësve, në stacionin e Brigadës zjarrfikëse në Autokomanda.

Kremtimi filloi me roje nderi të zjarrfikësve të Shkupit, ndërsa komandanti i Brigadës për mbrojtjen kundër zjarreve të Qytetit të Shkupit, Blagoja Menkovski, raportoi para Sekretarit të Qytetit të Shkupit, Marjanço Todorovski.



QYTETI I SHKUPIT NDËRMJET DESTINACIONEVE MË TË MIRA PËR INVESTIME

Qyteti i Shkupit në kongresin e katërt regional për ambient afarist miqësor në Europën Juglindore mori certifikatë për ambient afarist të volitshëm gjë me të cilën u klasifikua ndërmjet destinacioneve më të mira investuese në Europën Juglindore. Këtë Certifikatë Qyteti i Shkupit e mori në kongresin që u mbajt në Podgoricë, Mali i Zi në suazat e programit Certifikimi i komunave sipas biznesmenëve në Europën Juglindore (BFC SEE).

Në kongresin që u mbajt në muajin maj, certifikatë për ambient afarist të volitshëm në Republikën e Maqedonisë morën edhe komunat Shtip, Bogdanci dhe Gazi Baba. Përveç tyre, certifikatë për ambient afarist të volitshëm morën edhe 11 komuna nga regjioni, si Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe Kroacia.

Në përputhje me standardin BFC SEE në këtë moment ka 26 komuna të



certifikuara të cilat japin shërbime cilësore dhe ambient afarist të volitshëm për rreth 2 milion qytetarë dhe rreth 105.000 kompani, kurse mbi 60 komuna nga regjioni nëpërmjet programit BFC përmirësojnë ambientin afarist. Në rrjetin regional BFC SEE marrin pjesë 20 organizata dhe institucione nga

Maqedonia, Serbia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi që kontribuojnë për fuqizimin e bashkëpunimit të ndërsjellët dhe këmbimit të eksperiencave, dhe ndërmjet tyre janë ministri, dhoma ekonomike, shoqata dhe komuna, agjenci zhvillimi dhe universitete.

Me rastin e 1 qershorit – Dita ndërkombëtare e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës

PANAIRI NDËRKOMBËTAR I BAMIRËSISË 2016

Në qendrën tregtare të qytetit më 4 qershor u mbajt tradicionalisht „Panairi ndërkombëtar i bamirësisë 2016“, në të cilin në më shumë se 20 stenda përfaqësues të përfaqësive diplomatike në Republikën e Maqedonisë dhe organizata të tjera ndërkombëtare promovuan prodhime dhe dhurata nga vendet e tyre. Kryetar nderi i „Panairi ndërkombëtar i bamirësisë 2016“ është Çarls Garet, ambasador i Britanisë së Madhe në Republikën e Maqedonisë, kurse sponsor kryesor këtë vit është Qyteti i Shkupit.

- Ky manifestim u mbajt me rastin e 1 qershor, Dita ndërkombëtare e mbrojtjes së drejtave të fëmijës. Panairin e organizon shoqata „Dobrodojde Makedonija velkom centar“, kurse mjetet e grumbulluara



do të jepen për Qendrën ditore për fëmijë nga rruga – Shuto Orizare – tha kryetari Koce Trajanovski.

Në panairin në QTQ prodhime nga vendi i tyre prezantuan përfaqësues të ambasadave të Shqipërisë, Bullgarisë, Britanisë së Madhe, Italisë, Iranit, Serbisë, SHBA, Kinës, Sllovakisë, Sllovenisë, Turqisë, Francës, Malit të Zi, Spanjës, Holandës dhe Katarit, kurse u përfaqësuan edhe OBSE, Fondi monetar ndërkombëtar (FMM), delegacioni i UNICEF dhe delegacioni i Bashkimit Europian.

QYTETI I SHKUPIT DHE LIDHJA E PENSIONISTËVE NËN SHKRUAN MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM

Kryetari Koce Trajanovski në emër të Qytetit të Shkupit dhe Lidhja e pensionistëve të qytetit të Shkupit (LPSH) më 26 prill nënshkruan marrëveshje vjetore për bashkëpunim dhe përmirësimin e jetës kulturore, rekreative, sportive dhe edukative të pensionistëve, si dhe për realizimin e të drejtave të tjera sociale, të drejtat e pensionimit-invaliditetit dhe të drejtat nga sigurimi shëndetësor.

- Në përputhje me dispozitat e marrëveshjes së nënshkruar për bashkëpunim, si dhe në përputhje me Marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet Qytetit

të Shkupit dhe Lidhjes së pensionistëve të qytetit të Shkupit, Qyteti i Shkupit do të ndajë 600.000 denarë për organizimin e transportit në grup të pensionistëve në destinacione pikniku në territorin e Shkupit dhe në territorin e Republikës së Maqedonisë; transport falas për persona të moshuar, katër ditë në javë – të martën, të premten, të shtunën dhe të dielën; 17 milion denarë për legjitimacione falas për transportin publik urban për pensionistët invalidë; 400.000 denarë për përkrahjen dhe fuqizimin e Lidhjes së pensionistëve të qytetit të Shkupit dhe shoqatave të

cilat janë anëtarë të saj; 30.000 denarë për përkrahjen e manifestimeve sportive siç është turneu tradicional i shahut “13 Nëntori” dhe 67.000 denarë për përkrahjen e festimit të Ditës së pensionistëve të RM-së. Qyteti i Shkupit vitet e kaluara ka pasur një bashkëpunim të shkëlqyer me Lidhjen e pensionistëve të Qytetit të Shkupit, i cili bazohet në marrëveshjen e ndërsjellët dhe pjesëmarrje të përbashkët në realizimin e programeve dhe aktiviteteve të ndryshme me qëllim realizimin e jetës më cilësore të pensionistëve – theksoi kryetari Trajanovski, në nënshkrimin e Marrëveshjes.

Më 7 qershor në Shtëpinë e ARM-së u mbajt Koncerti republikan me këngë, muzikë dhe valle i pensionistëve 2016. Në këtë koncert morën pjesë 600 pjesëmarrës nga i gjithë vendi.



QYTETI I SHKUPIT QEVERISJA MAKINË TË BLERË PËR

Për të mbrojtur gjelbërimin dhe ambientin jetësor Qyteti i Shkupit muajin e kaluar bleu makinë për rimbjelljen e drurëve dhe kështu u bë qeverisja e parë vendore në regjion që disponon me një mekanizim të tillë.

- Qyteti i Shkupit bleu makinën për rimbjelljen e drurëve për nevojat e ndërmarrjes publike „Parqe dhe gjelbërim”. Automjeti është i markës IVECO, dhe në të është instaluar mekanizim plotësues dhe elektronikë për rimbjelljen drurëve. Me përdorimin e një mekanizimi të tillë gjatë rregullimit të gjelbërimit, fidanët do të mbillen dhe transportohen në mënyrë të shpejtë dhe efikase, pa dëmtuar drurin. Kjo



do të thotë që me një mekanizim të tillë, gjatë ndërtimit të infrastrukturës, nuk do të ketë nevojë për prerjen e drurëve të vjetër, por të njëjtët do të mbillen përsëri në një lokacion tjetër. Qyteti i Shkupit është qeverisja e parë vendore në regjion që ka blerë një makinë të tillë, e cila presim të ndihmojë në mënyrë të ndjeshme në punën e ndërmarrjes publike „Parqe dhe gjelbërim” dhe të japë kontribut të madh në mbrojtjen e ambientit jetësor – sqaron kryetari Koce Trajanovski.

Makina për rimbjelljen e drurëve ka në funksion katër lopata, të cilat kur janë të hapura arrijnë diametër deri nga 1,5 në 2,7 metra, ndërsa kur janë të mbyllura diametri është 1,7 deri në 2 metra. Gjatë punës pesha bartëse e pjesës plotësuese është nga 2.350 deri në 2.700 kilogram.

Kjo makinë mund të përdoret për mbjelljen e sërishme të drurëve me trashësi maksimale të trungut prej rreth 40 centimetrash.

Makina për rimbjelljen e drurëve do të shfrytëzohet atje ku lejojnë kushtet e terrenit dhe e njëjta nuk mund të përdoret në terren dhe lokacion ku ekzistojnë instalime nëntokësore në cektësi.

e gjelbërimit të qytetit

E PARË VENDORE ME RIMBJELLJEN E DRURËVE



Për blerjen e kësaj makine për rimbjelljen e drurëve Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 16 milion denarë, mjete të siguruar me Projektin për përmirësimin e shërbimeve komunale, të financuar me kredi nga Banka ndërkombëtare për rinovim dhe zhvillim – Banka botërore.



SHKUPI QYTETI I LULEVE

Ekipet e Qyteti të Shkupit dhe të NP „Parqe dhe gjelbërim” gjatë muajit të kaluar rregulluan me lule një numër të madh sipërfaqesh të gjelbra.

Me fidanët verorë të llojeve begonia, xhunxhule, lulja e mjalit, sardela petunia dhe lloje të tjera u zbukurua topi i luleve në bulevardin VMRO, trekëndëshat në bulevardin „Goce Delçev”, pjerrësia në rrethrotullimin e ri në Autokomanda, format e luleve në gjelbërimin para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, në Parkun e qytetit, në parkun „Maqedonia”, figurat „Mjellma” dhe „Lejleku” në Aerodrom, rreth rrethrotullimit tek SP „Planet” në Gjorge Petrov dhe në lokacione të tjera.

Në sipërfaqet e gjelbra publike u mbollën gjithsej 250.000 lule.



MIJËRA LULE ZBUKURUAN PARKUN E QYTETIT



Edicioni i tretë i Festivalit të luleve të Shkupit që u mbajt nga data 14 deri më 15 maj në pjesën e dytë të Parkut të qytetit, në hapësirën përballë „Parkut për kanakarë”, tërhoqi vëmendjen e një numri shumë të madh

qytetarësh, të cilët kishin mundësi të blejnë lule dhe aranzhime lulesh, të tregojnë shkathtësinë e tyre me lulet, të marrin këshilla të dobishme, të shoqërohen në ambient të hapur dhe të argëtohen.

Festivali i luleve i Shkupit këtë vit u mbajt nën moton „1.000 lule për Shkupin”. Sponsor i këtij festivali është kryetari i Qyteti të Shkupit, Koce Trajanovski, kurse organizator është NP „Parqe dhe gjelbërim”.

FIDANË FALAS PËR QYTETARËT

Qyteti i Shkupit edhe këtë pranverë vazhdoi aksionin tradicional për ndarjen e fidanëve për këshillat banesorë të interesuar dhe bashkësitë urbane dhe vendore, të cilave u ndau 2.000 drurë (gjetherënës dhe halorë) nga NP „Parqe dhe gjelbërim”.

Këshillave banesorë dhe bashkësive urbane dhe vendore në këtë aksion iu ndanë më së shumti deri në 10 fidanë. Aksioni i Qytetit të Shkupit për ndarjen e fidanëve organizohet tashmë nëntë vjet në dy etapa, pikërisht në pranverë dhe verë.

Edhe gjatë verës

VAZHDON RINOVIMI I SHKOLLAVE TË MESME

Për të përmirësuar kushtet në të cilat mësojnë nxënësit e shkollave të mesme, Qyteti i Shkupit edhe gjatë pushimeve verore do të rinovojë objektet e shkollave të mesme që janë nën kompetencat e tij. Këtë verë do të realizohen punë ndërtimore në 16 shkolla të mesme, kurse Qyteti i Shkupit për realizimin e këtij projekti planifikon nga buxheti të ndajë rreth 22 milion denarë.

Në SHMQSH „Nikolla Karev” në periudhën që vjen do të kryhet rinovimi i sallës së fizkulturës; në SHMQSH „Rade Jovčevski-Korčagin” do të rinovohet dyshemeja në sallën e fizkulturës; në SHMQSH „Josip Broz-Tito” do të rinovohet zdrukthëtaria e brendshme; në SHMQSH „Orce Nikollov” do të punohet në rinovimin e nyjave sanitare; në SHMQSH „Georgi Dimitrov” do të rinovohet fasada; në SHMQSH „Vasil Antevski Dren” do të punohet në rinovimin e dritareve; në SHMQSH „Marija Kyri Sklodovska” do të rinovohet dyshemeja e klasave; në SHMQSH „Dimitar Vlahov” do të rinovohet terreni sportiv; në SHMQSH



SHMQSH „Georgi Dimitrov”

„Vëllezërit Miladinov” do të rinovohet oborri i shkollës; në SHMQSH „Zdravko Cvetkovski” do të rinovohet dyshemeja e klasave; në SHMQSH „Arseni Jovkov” do të punohet në rikonstruksionin e dyshemeve të klasave; në SHMQSH „Lazar Tanev” do të rinovohen dyshemetë e klasave; në SHMQSH „8 Shtatori” do të punohet në rinovimin e dyshemeve të klasave; në SHMQSH „Zef Lush Marku” do të kryhet riparimi i çatisë; në SHMQSH „Cvetan

Dimov” do të rinovohen nyjat sanitare; në SHMQSH „Boro Petrusevski” do të rinovohet çatia e objektit ndihmës – punëtoria.

Punët ndërtimore për rikonstruksionin e objekteve dhe sallave sportive të shkollave të mesme të Qytetit të Shkupit do të kontribuojnë në plotësimin e standardeve për efikasitet energjetik dhe do të përmirësojnë në mënyrë të ndjeshme funksionalitetin dhe pamjen e objekteve shkollore.

Projekti i Qytetit të Shkupit dhe UNDP

U RIKONSTRUKTUA GODINA E SHMQSH „ORCE NIKOLLOV”



Në shkollën e mesme të Qytetit të Shkupit „Orce Nikollov” u zëvendësuan të gjitha dritaret e vjetra me dritare me efikasitet energjetik, u vendos çati e re me izolim, si dhe izolimi nga ana e brendshme e mureve të jashtme, me projektin që në fillim të vitit e realizoi Qyteti i Shkupit dhe UNDP.

- Në godinën e SHMQSH „Orce Nikollov” u zëvendësuan të gjitha dritaret e vjetra me dritare me efikasitet energjetik, u vendos çati e re me izolim, si dhe izolimi nga ana e brendshme e mureve të jashtme me stiropor me trashësi 10 centimetra. Gjatë punëve ndërtimore u freskua edhe fasada, përkatësisht u lyen

tullat me sipërfaqe 506 metra katrorë, dhe u lyen të gjithë trupat ngrohës në shkollë, në të cilët janë instaluar 163 ventile të rinj. Me marrjen e masave për efikasitet energjetik janë parashikuar kursime të energjisë rreth 30%, si dhe përmirësim i temperaturës ambientale në ambientet shkollore. I gjithë projekti kushton 3.588.057 denarë. Mjetet financiare për realizimin e këtij projekti janë grumbulluar nëpërmjet financimit të përbashkët të Qytetit të Shkupit dhe UNDP, kurse Qyteti i Shkupit mori pjesë me 2.000.000 denarë. Ne kemi përgatitur projekte për rikonstruksionin e fasadave me masa për efikasitet energjetik për të gjitha shkollat e mesme që janë nën kompetencat tona dhe gjatë viteve të ardhshme planifikojmë t'i realizojmë ato projekte. Në të njëjtën mënyrë me UNDP, nëpërmjet financimit të përbashkët, u krye rikonstruksioni i fasadës në SHMQSH „Josip Broz-Tito” dhe shpresojmë që edhe në të ardhmen do të bashkëpunojmë me UNDP dhe do të realizojmë projekte të suksesshme – theksoi kryetari Koce Trajanovski, në promovimin e projektit.

Luiza Uinton nga UNDP shprehu kënaqësinë e saj nga bashkëpunimi i shkëlqyer me Qytetin e Shkupit dhe theksoi tre përfitimet kryesore nga realizimi i këtij projekti, siç janë kursimi i shpenzimeve për ngrohje në masën 30%, zvogëlimi i emetimeve të gazrave të dëmshëm dhe krijimi i kushteve më të këndshme për mësim dhe punë të nxënësve dhe kuadrit mësimor në objektin shkollos.

SUKSES I MADH NË LIGAT E SHKOLLAVE TË MESME

Në garat përfundimtare në final-four që u mbajt nga data 12 deri më 13 maj në sallat sportive të SHMQSH „Koço Racin” dhe SHMQSH „Josip Broz-Tito” u dalluan ekipet më të mira në ligat e shkollave të mesme të Qytetit të Shkupit për vitin shkollor 2015/2016 në sportet ekipore në futsal, hendboll, basketboll dhe volejboll, në konkurrencën për meshkuj dhe femra.

Gjatë këtij viti shkollor në sistemin e garave të shkollave të mesme në Shkup morën pjesë 241 ekipe, dhe u luajtën më shumë se 1.000 ndeshje në të cilat u përfshinë rreth 6.100 nxënës nga 29 shkolla të mesme nga Shkupi. Sipas rezultateve nga garat finale, **në futsal – meshkuj ekipet më të mira ishin:**

Vendi i parë: **SHMK „Ilinden”**

Vendi i dytë: **SHMQSH „Zef Lush Marku”**

NË FUTSAL – FEMRA, më të mirat ishin:

Vendi i parë: **SHTSHKF „Metodi Mitevski - Brico”**

Vendi i dytë: **SHMQSH „Zef Lush Marku”**

NË HENDBOLL – FEMRA, vendet e para i fituan:

Vendi i parë: **SHTSHKF „Metodi Mitevski - Brico”**

Vendi i dytë: **SHMQSH „Nikolla Karev”**

NË HENDBOLL – MESHKUJ, ekipet më të mira ishin:

Vendi i parë: **SHTSHKF „Metodi Mitevski - Brico”**

Vendi i dytë: **SHMQSH „Josip Broz-Tito”**

NË VOLEJBOLL – MESHKUJ, vendet e para i fituan:

Vendi i parë: **SHMQSH „Orce Nikolov”**

Vendi i dytë: **SHMQSH „Zef Lush Marku”**

NË VOLEJBOLL – FEMRA, rezultatin më të mirë e arritën ekipet:

Vendi i parë: **SHMQSH „Orce Nikolov”**

Vendi i dytë: **SHTSHKF „Metodi Mitevski - Brico”**

NË BASKETBOLL – MESHKUJ, ekipet më të mira ishin:

Vendi i parë: **SHMQSH „Josip Broz-Tito”**

Vendi i dytë: **SHMQSH „Nikolla Karev”**

NË BASKETBOLL - FEMRA, më të mirat ishin:

Vendi i parë: **SHMQSH „Orce Nikolov”**

Vendi i dytë: **„Rade Jovčevski – Korçagin”**

Kampioni i qytetit dhe fituesi i vendit të dytë nga regjioni i Shkupit, që është më i madhi në Maqedoni, marrin pjesë në garat finale në nivel shtetëror. Kështu, shkollat e mesme nga Shkupi



në kampionatin shtetëror të shkollave të mesme nga Maqedonia – Gimnazijada që u mbajt në Kumanovë nga data 5 deri më 7 maj të këtij viti fituan 15 medalje ari, 6 argjendi dhe 6 bronzi.

Është e rëndësishme të përmendet se, si pjesë e ligave të shkollave të mesme të Qytetit të Shkupit organizohen 10 liga që zhvillohen gjatë gjithë vitit shkollor, në hendboll, basketboll, futsal, volejboll, ping-pong dhe qitje, kurse në pjesën e sporteve individuale organizohen gara në atletikë, badminton, karate dhe shah.

Qyteti i Shkupit nëpërmjet Lidhjes së sporteve të shkollave të mesme çdo vit investon në zhvillimin e sportit të shkollave të mesme. Për organizimin e sportit të shkollave të mesme në Shkup, Qyteti i Shkupit ndau 2.000.000 denarë.

Sa për të kujtuar, në vitin 2009 në ligat e shkollave të mesme morën pjesë rreth 300 nxënës–sportistë. Deri në vitin 2015, me aktivitet vijuese që ndërmori Qyteti i Shkupit së bashku me shkollat e mesme, në ligat e shkollave të mesme morën pjesë rreth 6.100 nxënës–sportistë.

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski më 26 maj u ndau Fletëlavdërimi dhe Mirënjohje drejtorëve, profesorëve të sportit dhe aktiviteteve sportive dhe përfaqësuesve të ekipeve sportive nga 29 shkolla të mesme nga Shkupi, për arritjen e sukseseve në ligat e shkollave të mesme të Qytetit të Shkupit, për vitin shkollor 2015/2016.



U LUAJT KUADRIL NË SHESHIN „MAQEDONIA“

Në sheshin „Maqedonia“ më 20 maj u mbajt manifestimi „Parada e maturës 2016“, kurse maturantët pikërisht në mesditë, së bashku me moshatarët e tyre nga shumë qytete nga vendi dhe Europa, luajtën vallëzimin kuadril nën tingujt e operës së Shtrausit „Lakuriqi i natës“.

Në „Parada e maturës“ e dhjeta me radhë në Shkup morën pjesë mbi 1.000 nxënës nga 20 shkolla të mesme në Shkup, si dhe maturantë nga Ohri, Struga, Strumica, Valandova, Gjevgjelia dhe Negotina. Para fillimit të vallëzimit kuadril maturantët bënë betimin për mospërdorimin e dhunës dhe tolerancë.

Organizatorë të „Parada e maturës“ së sivjetme janë Drejtoria e kulturës dhe arteve në Shkup në bashkëpunim me klubin e



vallëzimit „Ritam plus“, kurse sponsor i manifestimit është Qyteti i Shkupit. Përkrahës i këtij manifestimi tradicional është Delegacioni i Bashkimit European në Republikën e Maqedonisë.

U SHPËRBLIEN MATURANTËT MË TË MIRË



Kryetari Koce Trajanovski dhe kryetarja e Këshillit të Qyteti të Shkupit, Irena Misheva, 25 maturantëve më të mirë – nxënës të shkëlqyer të gjeneratës 2012/2016 nga 21 shkolla të mesme të Qytetit të Shkupit, u ndanë mirënjohje dhe shpërblime në para, si pjesë e manifestimit „Takimi ndërmjet të parit dhe më të mirëve“, që u mbajt më 10 qershor.

Laureatë të çmimeve dhe mirënjohjeve janë: nga SHMQSH „Lazar Tanev“ Hristijan Nikolovski dhe Bojan Radeski; nga SHMQSH „Josip Broz Tito“ Marija Magdalena Lazoska; nga SHMQSH „Koço Racin“ Bojan Dimoski; nga SHMQSH „Georgi Dimitrov“ Anastasija Demerxhieva; nga SHMQSH „Arseni Jovkov“ Andrijana Dimitrijeviq; nga SHMQSH „Zdravko Cvetkovski“ Teodora Stefanovska; nga SHMQSH

„Vëllezërit Miladinov“ Hristina Trpçevska; nga SHMQSH „Vlado Tasevski“ Zdravko Todorov; nga SHMQSH „Dimitar Vlahov“ Aneta Ivanova; nga SHMQSH „Cvetan Dimov“ Senad Dosljak dhe Hadis Feta; nga SHMQSH „Mihajlo Pupin“ Angel Davkovski; nga SHMQSH „8 Septemvri“ Nikita Gostoviq dhe Egzon Ramadani; nga SHMQSH „Dr. Pançe Karagjozov“ Emine Idrizi; nga SHMQSH „Zef Lush Marku“ Arnen Telkiu; nga SHMQSH „Boro Petrushevski“ Radmila Seneva dhe Aleksandar Cekovski; nga SHMQSH „Pançe Arsovski“ Martin Mladenovski; nga SHMQSH „Vasil Antevski Dren“ Laze Gjorgiev; nga SHMQSH „Orce Nikolov“ Filip Makraduli; nga SHMQSH „Nikolla Karev“ Maja Sareska; nga SHMQSH „Rade Jovčevski Korčagin“ Vera Dimovska dhe nga SHMQSH „Marija Sklodovska-Kyri“ Dragana Stojiq.

TOPA SPORTIVË TË RINJ PËR NXËNËSIT E SHKOLLAVE TË MESME

Kryetari Koce Trajanovski më 24 shkurt në sallën sportive të SHMQSH „Josip Broz Tito“ drejtorëve të 22 shkollave të mesme u ndau topa profesional.

Ndarja e topave sportivë u bë sipas numrit të nxënësve që ndjekin

mësimin në secilën nga 22 shkollat e mesme, përkatësisht Qyteti i Shkupit ndau nga 35 deri në 56 topa për çdo shkollë. Gjithsej u ndanë 963 topa, kurse për realizimin e këtij projekti Qyteti i Shkupit ndau 750.000 denarë.

„IKAS 2016“

Ukrainasi Igor Cvit fitoi në edicionin e 48-të të garës slalom Kanu Ilinden – „IKAS 2016“ që u mbajt më 9 dhe 10 prill në korsinë e QRS „Matka“.

Në këtë edicion të IKAS morën pjesë 150 garues nga 14 shtete. Manifestimi IKAS është një nga manifestimet sportive më të vjetra dhe më cilësore në Shkup dhe në Republikën e Maqedonisë. Qyteti i Shkupit përkrahu financiarisht „IKAS 2016“ me 190.000 denarë.

U HAPËN TERRENET E VOLEJBOLLIT DHE HENDBOLLIT NË RËRË

Terrenet e volejbollit dhe hendbollit në rërë në Plazhin e qytetit „Park“ nga muaji i kaluar janë hapur për shfrytëzim. Të gjithë qytetarët e interesuar, pushues, nxënës, studentë, klube sportive dhe shoqata civile mund të merren me sport dhe zbavitën në këto terrene me rërë.

Terrenet sportive do të jenë të hapura për sport dhe zbavitje çdo ditë nga **ora 10 deri në orën 24**. Caktimi i orarit mund të kryhet çdo ditë në vetë terrenin sportiv në periudhën e lartpërmendur dhe në numrin e telefonit **071/ 267- 265**. Orari për shfrytëzimin falas është me kohëzgjatje prej **1 ore**.

„I PARI DERI NË MAJË 2016“



Mbi 2.000 sportistë dhe amatorë morën pjesë në edicionin e sivjetmë të eventit më masiv alpinistik në Maqedoni „I pari deri në majë 2016“, që u mbajt më 22 maj, në malin Vodno. Në garat e mbajtura u dalluan këta garues:

Gara – çiklizëm rrugor: në këtë garë në konkurrencën për femra e para arriti Iveta Aleksieva, ndërsa në konkurrencën për meshkuj më i shpejti ishte Daniel Jakovlevski. Çmimin si ekipi më i mirë e fitoi ekipi „Enerxhi“.

Gara – çiklizëm malor: në këtë garë e para arriti në destinacion Cveta Kushovksa, kurse në konkurrencën për meshkuj vendin e parë e fitoi Aleksandar Grujoviq. Çmimin si ekipi më i mirë në çiklizëm malor e fitoi ekipi „Enerxhi“.

Gara - vrapim: në konkurrencën për femra vendi i pari i takoi Marija Stojanovska, kurse tek meshkujt më shpejti ishte Shtefan Vebel.

TURNË NË KARATE „GAZI BABA OPEN 2016“

Një nga turnetë më të mëdhenj në vendin tonë me karakter ndërkombëtar „Gazi Baba Open 2016“ këtë vit tërhoqi rreth 800 karateistë në të gjitha kategoritë nga 6 deri në 16 vjeç nga Sllovenia, Serbia, Kroacia, Kosova, Mali i Zi, Romania, Ukraina, Greqia, Austria dhe Bullgaria.

Ky turne që u mbajt për të 10-ën herë me radhë është nën organizimin e klubit të karatesë „Tigar“ nga Shkupi dhe përkrahet financiarisht nga Qyteti i Shkupit.



TURNË NË KARATE „SOLIDARNOST OPEN 2016“



Në edicionin e 16-të të turneut ndërkombëtar në karate „Solidarnost open 2016“ që u mbajt më 8 maj në sallën sportive të SHFK „Naum Naumovski Borçe“ morën pjesë mbi 500 garues nga shumë vende të regjionit.

Turneun e organizoi klubi i karatesë „Solidarnost“ nga Shkupi, dhe edhe këtë vit u përkrahu financiarisht nga Qyteti i Shkupit. Për përkrahjen shumëvjeçare të këtij turneu organizatori ndau mirënjohje për Qytetin e Shkupit dhe kryetarin Trajanovski.

REKORD I RI NË MARATONËN E SHKUPIT VIZ AIR 2016



Maratonasi kenian Kiprotiç Kirui më 8 maj fitoi në edicionin e 12-të të manifestimit më të njohur dhe më masiv në qytetin tonë "Maratona e Shkupit Viz Air 2016" dhe vendosi rekord të ri të maratonës, me kohën 2:12:36 orë. Ai pas vetes la bashkatdhetarët e tij Riçard Bet dhe Edvin Kirva, të cilët fituan vendin e dytë dhe të tretë në garën e maratonës në 42.195 metra, në konkurrencën për meshkuj. Ndërmjet maratonasve femra më e shpejta ishte Gledis Bivot nga Kenia, kurse në vendin e dytë dhe të tretë në konkurrencën për femra u klasifikuan Shevaj Debelu nga Etiopia dhe Fabiola Uiliam nga Tanzania.

Kupat dhe mirënjohjet maratonasve më të mirë të edicionit të 12-të "Maratona e Shkupit Viz Air 2016" ua ndau kryetari i Qytetit



të Shkupit, Koce Trajanovski.

Tek gjysmëmaratonasit i pari në finish arriti Ilir Kelezi nga Shqipëria, kurse për femra më e shpejta ishte Daniela Baraq nga Serbia. Gjysmëmaratonasve më të mirë shpërblimet ua ndau kryetarja e Këshillit të Qytetit të Shkupit, Irena Misheva.

Në garën humanitare në 5.000 metra në konkurrencën për meshkuj më i shpejti ishte Suad Kryeziu nga Maqedonia, kurse në konkurrencën për femra vendi i parë i takoi Renata Sokolovska nga Maqedonia. Si pjesë e "Maratona e Shkupit Viz Air 2016" ishte edhe stafeta e maratonës.

Më 8 maj në rrugët e Shkupit vrapuan mbi 7.000 maratonas, gjysmëmaratonas dhe amatorë nga 46 vende duke mbushur qytetin me energji pozitive. Edhe këtë vit, për këtë

manifestim Qyteti i Shkupit nga buxheti ndau 1.200.000 denarë, dhe në dispozicion ishin të gjitha ndërmarrjet publike të qytetit. Fondi i shpërblimeve të maratonës ishte 17.100 euro.

Edicioni i dymbëdhjetë i maratonës është nën kujdestarinë e Qytetit të Shkupit dhe misionit të Bashkimit Europian në vendin tonë.



TURNË NDËRKOMBËTAR NË SHAH „OPEN KARPOSH 2016"

Në edicionin e sivjetmë të turneut më të madh të shahut për klube në Republikën e Maqedonisë „Open Karposh 2016" morën pjesë rreth 200 shahistë nga 25 vende, nga të cilët 27 ishin mjeshtër të mëdhenj, 26 mjeshtër ndërkombëtarë, 3 femra mjeshtre ndërkombëtare, 22 mjeshtër të Fida-s, 2 femra mjeshtre

të Fida-s, 1 kandidat për mjeshtër dhe 1 femër kandidate për mjeshtre.

Turneu që u mbajt në fillim të prillit është nën organizimin e klubit të shahut „Gambit Aseko" nga Shkupi. Qyteti i Shkupit e përkrahu këtë turne me 200.000 denarë.

GARË-KROSI „GAZI BABA XC CHALLENGE"

Më 6 mars në korsitë e parkut të natyrës "Gazi Baba" u mbajt gara-kros „Gazi Baba IC Challenge" në të cilën morën pjesë mbi 100 garues në konkurrencën për meshkuj dhe femra. Në këtë garë garuesit vrapuan 8.000 metra, kurse garueset - 5.000 metra.

Në të dyja konkurrencat, të parët arritën Milosh Rançiq dhe Andrijana Pop Arsova.

Sponsor kryesor i garës-kros „Gazi Baba IC Challenge" është Qyteti i Shkupit, kurse u organizua nga klubi i atletikës „Indjuren" nga Shkupi.



AKSION PËR PASTRIM NË DITËN E PRANVERËS



Qyteti i Shkupit më 21 mars tradicionalisht kremtoi ditën e parë të pranverës me aksionin për pastrimin e pjesës së dytë të Parkut të Qytetit, si pjesë e manifestimit „Ditët e pranverës – ditët e ekologjisë”. Qëllimi i këtij aksioni ishte nxitja e kujdesit për ambientin jetësor tek qytetarët e Shkupit dhe dhënia e shembullit si të kujdesemi për ambientin në të cilin jetojmë.

Për këtë qëllim, në pjesën e dytë të Parkut të qytetit, në afërsi të Luna – Park, 150 nxënës të 5 shkollave të mesme të Qytetit të Shkupit (SHMQSH „Josip Broz -Tito, SHMQSH „Nikolla Karev”, SHMQSH „Orce Nikollov”, SHMQSH „Zdravko Cvetkovski” dhe SHMQSH „Georgi Dimitrov”) pastruan mbetjet nga sipërfaqet e gjelbra publike. Në bashkëpunim me Brigadën për mbrojtjen kundër zjarrit të Qytetit të Shkupit dhe NP “Parqe dhe gjelbërime” u pastrua me barkë liqeni në pjesën e dytë të parkut të qytetit. Anëtarët e qendrës për përkrahjen e personave me pengesa intelektuale „PORAKA”, nga ana tjetër, mbollën lule dhe u përfshinë në pastrimin e gjelbërimit.

Konferencë shkencore ndërkombëtare

„GREDIT 2016 – ZHVILLIMI I GJELBËR, INFRASTRUKTURA DHE TEKNOLOGJIA”

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski më 31 mars mori pjesë dhe iu drejtua konferencës shkencore ndërkombëtare „ GREDIT 2016 - zhvillimi i gjelbër, infrastruktura dhe teknologjia” që u mbajt në fakultetin Teknologjik-metalurgjik. Në këtë konferencë shkencore morën pjesë profesorë të njohur dhe shkencëtarë nga vendi dhe jashtë vendit, me vepra të tyre nga fusha e mbrojtjes nga ndotja të ajrit, ujit dhe truallit, vlerësimi i rreziqeve, burimeve të ripërtërishme dhe energjisë, bujqësisë dhe kualitetit të ushqimit, menaxhimit me mbetjet urbane dhe industriale, ndryshimeve klimaterike dhe biodiversitetit, qyteteve të gjelbra, shëndetit publik dhe tema të tjera nga fusha e mbrojtjes së ambientit jetësor.

- Kjo konferencë është tubimi më i madh shkencor-profesional nga fusha e mbrojtjes së ambientit jetësor që është mbajtur në Shkup. Dua të theksoj se në periudhën nga viti 2005 e këndej, Qyteti i Shkupit në përputhje me kompetencat e tij u angazhua me sukses në vendosjen bazave të të dhënave nga monitorimi i medimeve të ambientit jetësor dhe posedon të dhëna empirike për gjendjen e tyre; përgatiti dhe realizoi një varg dokumentesh strategjike dhe planifikuese dhe projekte nëpërmjet të cilave ndërmori një sërë aktivitete për mbrojtjen dhe përmirësimin e ambientit jetësor; vendosi sistem të integruar të menaxhimit të ambientit jetësor nëpërmjet realizimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara me Planin e Zhvillimit ekonomik lokal të parë dhe të dytë, përgatiti kadastrën e integruar të ambientit jetësor dhe kadastrën e gjelbër, vendosi sistem për menaxhimin e integruar me mbetjet, punon në dhënie e lejeve të integruara ekologjike dhe realizimin e vlerësimeve strategjike të ndikimit të planeve dhe projekteve dhe vlerësimin e ndikimeve nga projekte konkrete, realizimin e procedurave për elaborate për ambientin jetësor për aktivitete dhe veprimtaritë e parashikuara me ligj etj.; solli dhe realizoi PAEL – Planin aksionar për energji të qëndrueshme, popullarizoi zbatimin e masave për efikasitetet energjetik dhe zbatimin e burimeve të ripërtërishme



të energjisë në frymën e nënshkrimit të Kartës së kryebashkiakëve për zvogëlimin e emetimeve të dyoksidit të karbonit; promovoi Qendrën për menaxhimin dhe drejtimin me komunikacionin (QMKK), gazifikoi 4 shkolla të mesme të Qytetit të Shkupit, blemë automobil elektrik për nevojat e administratës së qytetit, si dhe elektromopedë, elektrotrotinetë dhe elektromobila; punon në zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit, hulumton shenjë e tij ekologjike si tregues i kualitetit të jetesës në qytet; vendos sistem të qëndrueshëm transporti, me favorizimin dhe krijimin e kushteve më të mira për shfrytëzimin e transportit publik dhe biçikletave; krijon kushte për valorizimin, shpalljen, mbrojtjen, avancimin dhe rregullimin e rritjeve natyrore në territorin e vet; punon në mënyrë aktive në realizimin e projektit për përmirësimin e infrastrukturës së çiklizmit në qytet, „SHKUPI QYTETI I BIÇIKLETAVFE 2017”, kurse deri tani ngritëm dhe rregulluam rreth 415.000 metra katrorë sipërfaqe të gjelbra – tha kryetari Trajanovski, para të pranishmëve.


Trajanovski theksoi se edhe Qyteti i Shkupit punon në mënyrë aktive për zvogëlimin dhe adaptimin me ndryshimet klimaterike dhe në sjelljen e Strategjisë për ndryshimet klimaterike për Shkupin dhe realizimin e Planit aksionar, si dhe rritjen e rezistencës urbane ndaj katastrofave natyrore dhe teknologjike.

SHUARJA E LLAMBAVE PËR „ORA E PLANETIT TOKË“

Qyteti i Shkupit më 19 mars ishte pjesë e aksionit „Ora e planetit Tokë“ – aksioni më i madh vullnetar botëror që ka për qëllim nëpërmjet shuarjes simbolike të ndriçimit gjatë një ore të dërgojë mesazh të fuqishëm për shpëtimin e planetit. Motoja e aksionit global këtë vit është „Shndrit llambën e ndryshimeve klimaterike“.

Aksioni „Ora e planetit Tokë“ zgjati nga ora 20:30 deri në orën 21:30, kurse ndriçimi u fik në shumë lokacione në qendrën e qytetit: rruga „Maqedonia“, pallati Pelister“, Pallati „Risti“, Ura e gurit, Kalaja e Shkupit, parku „Zhena borec“ dhe monumentet, sheshi „Filipi i dytë“, ura „Oko“ dhe Ura e artit. Si pjesë e eventit në rrugën „Maqedonia“ u zhvillua performanca me 300 qirinj.

Kjo lëvizje ekologjike globale është krijuar nga WWF (World Wildlife Fund), dhe përkrahët nga Kombet e Bashkuara. Në kremtimin e „Ora e planetit Tokë“ u përfshinë mbi 170 vende, kurse shumë qytete nëpër botë përkrahën këtë aksion me shuarjen simbolike të ndriçimit të monumenteve, godinave, urave, kandelabreve, parqeve etj.



DITA E PLANETIT TOKË



Qyteti i Shkupit dhe Shoqata për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e ambientit jetësor „Go Green“ më 22 prill në Parkun e qytetit kremtoi 22 prillin – Dita e planetit Tokë. Në hapësirën rreth Guaskës në Parkun e qytetit u vendosën tre stenda, kurse vullnetarët-nxënës të shkollave të mesme të Qytetit të Shkupit kalimtarëve u ndanë karta me mesazhe ekologjike dhe fara borziloku dhe prkosi.

Në brezin e gjelbër para guaskës, nga ana tjetër, u mbollën gjashtë fidanë halorë - tui.

AKSION PËR PASTRIMIN E LIQENIT „MATKA“

Me rastin e 22 marsit – Dita botërore e ujërave, Qyteti i Shkupit në bashkëpunim me Shoqatën e zhytësve „Vrelo“ nga Shkupi dhe me Ministrinë e ambientit jetësor dhe planifikimit të hapësirës organizoi pastrimin e brigjeve të lumit Treska dhe liqenit „Matka“.

Në aksionin për pastrimin e mbetjeve të forta nga sipërfaqet e gjelbra dhe publike në këto lokacione u përfshinë përfaqësues të administratës së Qytetit të Shkupit, përfaqësues të MAJPH, organizata joqeveritare dhe qytetarë. Zhytësit e shoqatës „Vrelo“ të ndihmuar nga kolegët e tyre nga Negotina dhe Ohri mënjanuan mbetjet nga liqeni „Matka“.



BASHKËPUNIMI



Kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski më 10 qershor u takua me nxënësit e shkollave të mesme të qytetit Temp, SHBA, të cilët tradicionalisht, çdo vit vijnë në këmbimin shkollor ndërkombëtar tek moshatarët e tyre në Shkup.

- Është kënaqësi e madhe për ne që edhe këtë vit jemi nikoqirët tuaj. Ky këmbim i nxënësve është vetëm pjesë e aktiviteteve ndërmjet Shkupit dhe Tempit, dy qytete të cilat kanë bashkëpunim të shkëlqyer që daton nga binjakëzimi në vitin 1971. Shpresoj se do të keni qëndrim të këndshëm në Maqedoni dhe Shkup dhe, se do të keni mundësi të njiheni nga afër me kulturën, traditat dhe historinë tonë – tha kryetari Trajanovski, në takim.

Tradicionalisht, nxënësit e shkollave të mesme të Shkupit do të shkojnë për vizitë në Temp më 14 korrik dhe do të qëndrojnë 5 javë.

Më 27 prill kryetari Koce Trajanovski realizoi takim me delegacionin nga komuna Shìçeng nga Pekini, Republika Popullore e Kinës, e udhëhequr nga kryetari komunës, Vang Shaofeng. Në takim mori pjesë edhe ambasadori i R.P. të Kinës në vendin tonë, Ven Zhenshun. Shìçeng është një nga 16-të komunat e Pekinit dhe është qendër administrative, politike dhe ekonomike e qytetit.

- Binjakëzimi juaj me komunën e Shkupit Qendër përbën një shembull të mirë për bashkëpunimin edhe për komunat e tjera nga Shkupi dhe Pekini – deklaroi kryetari Trajanovski.



Bashkëpunimi ndërkombëtar, urbanizmi dhe komunikacioni rrugor ishin ndërmjet temave kryesore në takimin ndërmjet kryetarit Koce Trajanovski dhe delegacionit nga Torinoja, Republika e Italisë, që u mbajt më 21 mars. Në takim mori pjesë edhe ambasadori i Italisë në Republikën e Maqedonisë, Ernesto Masimino Beleti.

Delegacioni përbëhej nga përfaqësues të administratës së qytetit të Torinos nga sfera e bashkëpunimit ndërkombëtar, urbanizmit dhe komunikacionit rrugor, përfaqësues të Dhomës ekonomike të Torinos, si dhe profesorë të arkitekturës dhe dizajnit pranë Universitetit të Torinos. Kryetari Trajanovski në takim theksoi se bashkëpunimi ndërmjet Torinos dhe Shkupit është në nivel të lartë, veçanërisht pas nënshkrimit të Marrëveshjes për miqësi dhe bashkëpunim në vitin 2012.

Nën moton „Frankofonia hap dyert!“ më 19 dhe 20 mars në QKR u mbajt një numër i madh aktiviteteve si pjesë e manifestimit „Ditë të Frankofonisë në Maqedoni“.

- Republika e Maqedonisë është anëtare me të drejta të plota e Organizatës ndërkombëtare të Frankofonisë nga viti 2006 dhe përkrah dhe kultivon gjuhën, kulturën dhe vlerat franceze. Në suazat e kësaj organizate Qyteti i Shkupit kultivon marrëdhënie miqësore me shumë qytete frankofone ndërkombëtare, rrjete të qyteteve, asociacione, shoqata dhe organizata. Qyteti i Shkupit është binjakëzuar me qytetet franceze Dizhon dhe Rube me të cilët kultivon bashkëpunim të suksesshëm – tha kryetari Koce Trajanovski, në hapjen e manifestimit.

Si pjesë e këtij manifestimi u mbajtën një numër i madh punëtorish interaktive dhe aktiviteteve argëtuese për nxënësit e shkollave të mesme dhe studentët, kurse në sallinin e QKR-së u paraqitën kompanitë frankofone dhe operatorët në Maqedoni, ndërsa ligjërata me temë „Frankofonia dhe globalizmi“ u mbajt nga Iv Montene, specialist i gjeopolitikës dhe menaxher.



NDËRKOMBËTAR



Kryetari Koce Trajanovski dhe kryetarja e Këshillit të Qytetit të Shkupit, Irena Misheva, më 4 shkurt u takuan me delegacionin e qytetit të binjakëzuar Nançang, Republika Popullore e Kinës.

Delegacioni nga Nançangu udhëhiqej nga Vei Guohua, zëvendësdejtore i Komitetit ekzekutiv të Kongresit Popullor të Nançangut, kurse në delegacion ishin të pranishëm edhe përfaqësues të pushtetit lokal dhe regional nga fusha e bashkëpunimit ndërkombëtar, kulturës dhe marrëdhënieve me publikun.

- Shkupi dhe Nançangu janë binjakëzuar 31 vite më parë, kurse ky

është viti i dytë me radhë që në Shkup kremtohet Viti i Ri kinez me shfaqjen e ansamblit kulturor nga Nançangu. Në drejtim të thellimit të bashkëpunimit tonë planifikojmë gjatë këtij viti një delegacion nga Shkupi të vizitojë Nançangun, kurse si fusha potenciale për zhvillimin e bashkëpunimit janë bashkëpunimi ekonomik dhe turizmi – deklaroi kryetari Trajanovski.

Në Teatrin popullor të Maqedonisë, mbrëmjen e 4 shkurtit u mbajt shfaqje muzikore dhe vallëzimi nën koreografinë e ansamblit kulturor nga Nançangu, me rastin e Vitit të Ri kinez.



Thellimi i bashkëpunimit të Qytetit të Shkupit me Asociacionin e qendrave për zhvillimin e biznesit të Bashkimit European në Irlandë dhe puna në fushën e inovacioneve në biznes ishin tema të takimit ndërmjet kryetarit Koce Trajanovski, Xho Gritit, drejtor i Qendrës inovative të biznesit perëndimor në Galvej, Irlandë, dhe kryesues i Asociacionit të qendrave për zhvillimin e biznesit të Bashkimit European në Irlandë dhe Ilija Buçkov, kryetar i Qendrës europiane-maqedonase për inovacione dhe dije (EMKICE), që u mbajt më 2 shkurt.

Në takim u diskutua edhe për formimin e Qendrës inovative të biznesit në Shkup dhe përfshirjes së saj në rrjetin europian të qendrave të tilla.

Kryetari Koce Trajanovski më 15 janar realizoi takim me delegacionin nga qyteti i Varshavës, Republika e Polonisë, i përbërë nga zëvendësdejtore i Byrosë për kulturë të qytetit të Varshavës, Malgozhata Naimska, drejtore i Shtëpisë së takimeve me historinë e Qytetit të Varshavës, Piotr Jakubovski dhe ambasadorit të Republikës së Polonisë në vendin tonë, Jacek Stefen Multanovski.

Në takim u diskutua për ekspozitën „Feniksi nga hiri – Shkatërrimi dhe rinovimi i Varshavës 1939-1955“ e cila u vendos në Muzeun e Qytetit të Shkupit.

- Në takim u diskutua për bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet Shkupit dhe Varshavës. U rakordua që në periudhën e ardhshme të thellojmë bashkëpunimin tonë nëpërmjet këmbimit të artistëve dhe historianëve nga të dy qytetet – tha kryetari Trajanovski.





Program i pasur kulturor në „VERA E SHKUPIT“

